



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 1034/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e Fjoralba Raci, kandidate për anëtarë në Kuvend të Komunës së Istogut, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Istog, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 2948/2021, të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërim e të gjitha fletëvotimeve për kandidatët e kuvendit komunal në Vushtrri, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.1034/2021, i paraqitur nga Fjoralba Raci, kandidate për anëtarë në Kuvend të Komunës së Istogut, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Istog, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 2948/2021, të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërim e Qendrave të Votimit 0602C, 0605C, 0608C, 0620C, 0612C, 0613C, 0618C, 0622C, për Zgjedhjet e Lokale 2021.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 04.11.2021 Fjoralba Raci, kandidate për anëtarë në Kuvend të Komunës së Istogut, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Istog, ka parashtuar apel në PZAP lidhur me pa rregullsitë e ndodhura gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotime dhe KKZ në Istog dhe ka shpërputhje të madhe të raportimeve nga ana e vëzhguesve dhe FRP-ve zyrtare të dala nga KKZ. Parashtruesja e apelit kërkon që të bëhet rinumërimi i plotë i kutive të votimit për Qendrat e Votimit 0602C në Banjë, 0605C në Zallq, 0608C në Rakosh, 0620C në Cërreç, 0612C në Kovragë, 0613C në Uçë, 0618C në Osojan, 0622C në Llukac të Begut dhe 0601C në Istog,

Andaj lidhur me këtë ankesë ka bashkangjitur kopje të letërnjoftimeve të disa personave me të cilën pretendon se janë qytetar dhe familjarë të ngushtë të saj dhe të cilët kanë shprehur gatishmërinë ti bashkangjiten ankesës në fjalë për të informuar lidhur me votat e tyre në këto vendvotime.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin, si dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

### **Apeli është i pabazuar.**

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi pretendimet në apel dhe kopjet e letërnjoftimeve të disa qytetarëve të bashkangjitur në apel nga ana e ankuesit, mirëpo gjeti se të njëjtit nuk janë bazë e mjaftueshme për të kolauduar se në këto vendvotime ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtruesit të apelit se apelin e mbështet në pohimet e familjarëve dhe miqve të saj nuk është i argumentuar, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidatja ka pretenduar në apel. Në rastin konkret apeluesi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër pos disa kopjet të letërnjoftimeve të disa qytetarëve, duke mos bashkangjitur asnjë deklaratë e cila do shërbente si provë, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Fjoralba Raci, kandidate për Kuvend të Komunës së Istogut, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Istog, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat, andaj kërkesa e apeluesit për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet e gjitha Qendrave të Votimit në Istog, vlerësohet si i pa bazuar. Shkaqet për rinumërimin e plotë të gjitha fletëvotimeve në një Komunë të tërë, sipas vlerësimit të panelit do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr 1034/2021 më datën 07.11.2021

**Kryesuesejsa e Panelit**

Milena Đerić



*Milena Đerić*

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas par. 18 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.